V E N D I M
Nr.91, datë 9.3.1994

PËR ÇMIMET E SHITJES SË SHEQERIT PËR POPULLSINË

Në mbështetje të ligjit Nr.7581, datë 7.7.1992"Për çmimet dhe tarifat", ndryshuar me ligjin Nr.7646, datë *.12.1992, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për uljen e fitimeve spekulative çmimi i shitjes me pakicë të sheqerit caktohet 6O lekë për kg. Ky çmim të konsiderohet si mim tavan dhe i detyrueshëm për zbatimin nga të gjitha subjektet përkatëse treguesa të tij.

Çmimi i shitjes së sheqerit ndërmjet vetë subjekteve të vazhdojë të jetë i liberatizuar, duke u caktuar në marrëveshje mes palëve.

2. Për çmimin e shitjes me shumicë të sheqerit që vjen me kuadrin e ndihmave shtetërore, të zbatohen vendimet dhe udhëzimet në fuqi të Këshillit të Ministrave ërkatësisht për organizimin , pritjen, shpërndarjen e administrimin e ndihmave shtetërore, si dhe për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore të shitjes me ankand të mallrave me shumicë.

3. Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë të njoftojë periodikisht Këshillin e Ministrave për ecurinë e çmimeve të shitjes së sheqerit dhe, me krijimin e kushteve të përshtatshme e me miratim të Ministrisë së Financave t'i propozojë Këshillit të Ministrasve për marrjen e masave dhe kryerjen e ndryshimeve të tjera përkatëse.

4. Ngarkohen organet shtetërore përkatëse të kontrollit për zbatimin e cmimit tavan të sheqerit të caktuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi